

V E N D I M
Nr.90, datë 1.3.1993

PËR MIRATIMIN E STRATEGJISË SË TURIZMIT NË SHQIPËRI

Me propozimin e Ministrisë së Turizmit, Këshilli i Ministrave,

V E N D O S I:

1. Miratimin e strategjisë së zhvillimit të turizmit në Shqipëri për vitet 1993-2010, e cila do të shërbejë si program i qeverisë për zhvillimin e turizmit.
2. Ministria e Turizmit të ndjekë e të kontrollojë realizimin e objektivave që përcaktohen në strategjinë e zhvillimit të turizmit në vendin tonë.
3. Ministrinë dhe institucionet e tjera qendrore ngarkohen të përcaktojnë detyrat që u dalin nga strategjia e zhvillimit të turizmit dhe të bashkërendojnë punën me Ministrinë e Turizmit për të siguruar mbështetjen e realizimit të strategjisë së zhvillimit të turizmit.
4. Ministrinë dhe institucionet e tjera qendrore ngarkohen të bashkërendojnë programet e zhvillimit të veprimtarive që ato drejtojnë me strategjinë e zhvillimit të turizmit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE
Aleksandër Meksi